



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
GJIROKASTËR



Nr.36[72008-00159-21-2017] Akti  
Nr.36[21-2017-512] Vendimi

Datë regjistrimi 02.03.2017  
Date vendimi 28.03.2017

VENDIM  
PER PLOTESIM VENDIMI PENAL

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me trup gjykues të përbërë me

**Gjyqtare: MIRELA ILIOPULLO**

Asistuar nga sekretare gjyqësore *Flutura Basho*, sot në Gjirokastrë, më datë 28.03.2017, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kërkesën penale me Nr. 36[72008-00159-21-2017] Akti, që i përket kërkesës me:

**KËRKUES:** **Flamur Abazi**, i biri i Myftarit dhe i Xhemile, i datelindjes 26.10.1965, lindur dhe banues në Memaliaj, Tepelene, përfaqësuar në gjykim me prokuror nga av. Arjan Sotiri, anetar i Dhomes së Avokatisë Gjirokastrë .

**PERSON I TRETË :** **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, përfaqësuar nga prokurori Julian Cafka.

**OBJEKT:** Kthimin e mjetit të sekuestruar, xhip i markës Range Rover, me targa "AA 232 JL" me nr. shasie "SALWA2KFXEA369947" me porta, ngjyrë e zezë, me dy pasqyra, me disqe alumini si dhe celësin e automjetit, sekuestruar me "proces verbalin për sekuestrimin e sendeve" të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Gjirokastrë si dhe të dokumentacionit të sekuestruar me proces verbalin e sekuestrimit të sendeve (dokumentave) po të datës 04.09.2016 e pikërisht:  
Një kartë c' rregjistrimi për prerje dogane me të dhënat e automjetit, me mbishkrime "SRB", BG 1002-DV, datë 20.06.2016 në emër të Vasic Nikola.  
Një siguracion datë 20.06.2016 për mjetin me targë BG-1002-DV.  
-një siguracion i vjetër serb për këtë automjet.  
-një dokument me emërtimin Ugovor O kupoprodaji motoring vozila i datës 19.08.2016 në emër të Vasic Nikolla dhe Flamur Abazi për automjetin e mësipërm.  
-një fotokopje e kartës me të dhënat e mjetit.

Gjykata pasi shqyrtoi dhe mori provat, në përfundim të shqyrtimit, dëgjoji konkluzionet përfundimtare të paleve ku:

Kerkuesi kerkoi : *Pranimin e kerkeses sipas objekti te saj*

Prokurorin Julian Cafka, i cili kerkoi: *Rrezimin e kerkeses.*

dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen dhe provat e paraqitura,

### VËREN

Kerkuesi Flamur Abazi, i eshte drejtuar Gjykates me kerkese per Kthimin e mjetit të sekuestruar, xhip i markës Range Rover, me targa "AA 232 JL" me nr shasie "SALWA2KFXEA369947" me porta, ngjyrë e zezë, me dy pasqyra, me disqe alumini si dhe celësin e automjetit, sekuestruar me "proces verablin për sekuestrimin e sendeve" të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Gjirokastër; si dhe të dokumentacionit të sekuestruar me proces verbalin e sekuestrimit të sendeve (dokumentave) po të datës 04.09.2016 e pikërisht: Një kartë c' rregjistrimi për prerje dogane me të dhënat e automjetit, me mbishkrime "SRB", BG 1002-DV, datë 20.06.2016 në emër të Vasic Nikola. -një siguracion datë 20.06.2016 për mjetin me targë BG-1002-DV.-një siguracion i vjetër serb për këtë automjet. -një dokument me emërtimin Ugovor O kupoprodaji motoring vozila i datës 19.08.2016 në emër të Vasil Nikolla dhe Flamur Abazi për automjetin e mësipërm. -një fotokopje e kartës me të dhënat e mjetit.

Gjykata, pasi studioi materialet e paraqitura, në vështrim të neneve 13, 69, 74 dhe 76 të Kodit të Proçedurës Penale, çmoi se është në juridiksionin dhe kompetencën e saj, gjykimi i kësaj kerkese. Gjithashtu, bazuar edhe në nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Proçedurës Penale çmoi se, nuk ka shkaqe papajtueshmërie apo, përjashtimi që të mos lejojnë gjykimin e kësaj çështjeje, nga kjo Gjykatë.

*Sa më sipër, gjykata vendosi të kalojë për gjykim, kërkesën penale sipas objektit të saj, ku gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se,*

Ne seancën gjyqësore, pala kerkuese pretendon se : Me "Proces verbalin për sekuestrimin e sendeve" të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Gjirokastër, të datës 04.09.2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokaster ka sekuestruar mjetin xhip i markës Range Rover, me targa "AA 232 JL" me nr shasie "SALWA2KFXEA369947" me porta, ngjyrë e zezë, me dy pasqyra, me disqe alumini si dhe celësin e automjetit.

Me proces verbalin e sekuestrimit të sendeve(dokumentave) të datës 04.09.2016 janë sekuestruar: Një kartë c' rregjistrimi për prerje dogane me të dhënat e automjetit, me mbishkrime "SRB", BG 1002-DV, datë 20.06.2016 në emër të Vasic Nikola. një siguracion datë 20.06.2016 për mjetin me targë BG-1002-DV. një siguracion i vjetër serb për këtë automjet. një dokument me emërtimin Ugovor O kupoprodaji motoring vozila i datës 19.08.2016 në emër të Vasic Nikolla dhe Flamur Abazi për automjetin e mësipërm. -një fotokopje e kartës me të dhënat e mjetit.

Ky mjet i është sekuestruar shtetasit Vladrin Tasim Spahiu, i cili është akuzuar për veprën penale "Kundërshtim të punonjësit të Policisë".

Mjeti i sekuestruar nuk ka lidhje me ngjarjen e ndodhur, nuk përbën provë për hetim. Mjeti i sekuestruar është në pronësinë time.

I është drejtuar Prokurorisë Rrethit Gjirokastrë për të bërë kthimin e tij por nuk më është dhënë asnjë përgjigje, prandaj i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë , për të kthyer mjetin e sekuestruar si dhe dokumentacionin e tij.

Ka kaluar një kohë shumë e gjatë, është tejkaluar cdo afat ligjor për kthimin e mjetit dhe sendeve të sekuestruara prej personit të tretë.

Mjeti dhe dokumentacioni i tij, sekuestruar me proces verbalet përkatëse, janë pasuri imja. Prokurori kerkoi rrezimin e kerkeses, pasi ceshtja ende ne hetim dhe nuk ka perfunduar hetimi i ceshtjes .

Kerkuesi e ka bazuar kerkimin e tij ne nenin 301/2 te Kodit te Procedures Penale.

Ne nenin 301/2 te Kodit te Procedures Penale percaktohet se : *"Prokurori, brenda 48 oreve oreve te ardhshme , me vendim te motivuar vlefteson sekuestron , ne qofte se ekzistojne kushtet ose vendos kthimin e sendeve te sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit te cilit i jane sekuestruar sendet. Kunder tij mund te behet ankim ne gjykate brenda 10 diteve nga i pandehuri dhe mbrojtesi i tij , nga personi te cilit i jane sekuestruar sendet dhe ai qe ka te drejten t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros."*

Kerkuesi e ka paraqitur kerkesen e tij ne daten 02.03.2017.

Proces verbali per sekuestrimin e automjetit mban daten 04.09.2016.

Referuar dispozites se mesiperme,rezulton se kerkuesit i ka perfunduar e drejta per te ushtruar ankim ne Gjykate perpara se kerkuesi te ngrinte kerkesen ne Gjykate.

Gjykata konstaton se kerkesa e kerkuesit ka kaluar afatin 10 ditor qe ligji ka parashikuar per ankimet e vendimeve te sekuestros.

Ne keto kushte, Gjykata cmon se kerkesa duhet te rrezohet si e pabazuar ne ligj.

### PËR KËTO ARËSYE

Gjykata, bazuar në nenin 301/2 të Kodit të Proçedurës Penale

### VENDOSI:

- Rrezimin e kerkeses.
- Shpenzimet gjyqesore sic jane kryer.
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Gjirokaster.

U shpall ne Gjirokastrer, sot me date 28.03.2017

GJYQTARE  
MIRELA ILIOPULLO